



Prioritetet e Këshillave Lokal

Projekti: “Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë”

Organizata joqeveritare Syri i Vizionit nga Peja, në kuadër të projektit “Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë” ka mbajtur takime me kryetarët e këshillave lokal në gjashtë (6) komuna ku ky projekt shtrihet: Rahovec, Gjakovë, Deçan, Klinë, Istog dhe Pejë.

Qëllimi i këtyre takimeve me kryetarët e këshillave lokal ishte radhitja e prioriteteve, tri (3) deri në pesë (5) me të rëndësishmeve për lokalitetin e tyre, në mënyrë që komunat në investimet e tyre kapitale dhe planifikimet buxhetore për vitin 2023 t'i përfshijnë këto prioritete duke ndikuar në përmirësimin e drejtpërdrejtë të kushteve të jetesës dhe mirëqenien e banorëve dhe rritur transparencën e investimet me përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve.

Duhet theksuar se në takimin me kryetarët e këshillave lokal nuk kanë marrë pjesë të gjithë kryetarët, pavarësisht ftesave të dërguara me kohë dhe mundësisë së ofruar që prioritetet e tyre t'i adresojnë tek ne edhe me shkrim.

Prioritetet e dala nga takimi me kryetarët e këshillave lokal në komunën e Deçanit janë si më poshtë:

Prioritet e këshillave lokal të dala nga pjesëmarrësit në takim

Kodralli

1. Kanali për ujitjen e tokave bujqësore diku 300 metra, i cili përfshin fshatrat Kodrali, Pozhar dhe Irzniq
2. Ndërtimi i dy kanaleve (vijave) për ujitje diku 2000 metra në lagjet Pepaj, Idrizaj dhe Gjonaj si dhe tjera në lagjen Rizaj dhe Vishaj me një gjatësi prej 2000 metrash
3. Ndërrimi i një rezervuari shtesë për furnizim më ujë të pijes
4. Asfaltimi i rrugicave në 9 lagje diku 5 kilometra.

Ratishë e Ulët

1. Vazhdimi i asfaltimit të rrugicave përbrenda fshatit diku 3 kilometra, nga ambulanta deri në fund të fshatit
2. Ndërtimi i digave “Seishtave” në përroin e Ratishës ku do të sigurohet ujitja për 50 hektarë të tokës bujqësore/punuese
3. Sigurimi i ujit të pijes gjatë sezonit të verës
4. Tensioni i lartë i rrymës të vazhdohet prej Ratishe të Ulët në Dashinoc dhe Maznik
5. Ndërtimi i trotuarit për këmbësorë nga qendra e fshatit deri në shkollë, afro 900 metra
6. Kanalizimi për ujërat e zeza
7. Ndriçimi publik i fshatit.

Glllogjan

1. Ndërtimi i rrjetit të kanalit për ujërat e zeza
2. Furnizimi me ujë të pijes
3. Ndërtimi i trotuareve në lagjen Ahmetaj, Nimaj, Bajramaj e Zeqiraj
4. Riparimi i rrjetit elektrik në tërë fshatin, pasi ekziston rrjeti i vjetruar i vitit 1966. Të bëhet vendosja e shtyllave dhe telit të ri
5. Ndërtimi i kanaleve për ujitje në lagjen Ahmetaj dhe Zeqiraj dhe të vazhdohet deri tek “Arat e Mëdhaja” ku do të ujitën mbi 1000 hektarë tokë bujqësore/punuese.

Shaptej

1. Ndërtimi i trotuarit për nxënës nga shkolla e Glllogjanit deri në fund të fshatit me një gjatësi prej 1 kilometri
2. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujëra të zeza
3. Riparimi i rrjetit elektrik, gjegjësisht ndërrimi i shtyllave dhe rrjetit/telave
4. Furnizimi me ujë të pijes
5. Asfaltimi i rrugicave të fshatit diku 1.5 kilometra.

Deçan qyteti

1. Riparimi i kanalit të ujitjes nga qendra e qytetit deri te Manastiri, i cili ka një gjatësi diku deri 2 kilometra
2. Ndërtimi i kanalit për ujitje në lagjen Kuqi dhe Osaj, diku 2 kilometra
3. Përmirësimi dhe lehtësimi i sistemit/procedurave të tokave për subvencionim
4. Rregullimi i mulliri të Pazari i Vjetër i Ibërhysajve.

Dashinoc

1. Të bëhet vendosja e rrjetit të tensionit të lartë në Ratishë, Dashinoc dhe Maznik (tensioni i lartë) linjë e re
2. Asfaltimi i rrugicave të fshatit - diku 5 rrugica në lagjen Sokolaj, 800 metra, Gjokaj, 300 metra, rruga e Kronit dhe ajo e Lugut
3. Kanali i ujitjes prej shpërndarësit të ujit diku 1.5 kilometra, i cili siguron ujitjen e mbi 50 hektarëve tokë bujqësore/punuuese
4. Furnizimi me ujë të pijes.

Irzniq

1. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e zeza
2. Ndërtimi i kanaleve për ujitje në lagjen Dervishaj dhe Dobraj me një gjatësi 1.5 deri 3 kilometra
3. Ndërtimi i kanalit Duraku
4. Lirimi i pronave publike nga uzurpimet që po bëjnë banorët dhe parcelizimi nga drejtoria përgjegjëse/kadastër e gjeodezi
5. Asfaltimi i rrugicave në tërë fshatin, të cilat në total përbëjnë gjatësinë prej diku 2 kilometrash.

Prapaqan

1. Rrjeti i kanalizimit për fshatin
2. Betonimi i kanaleve të ujitjes diku 1200 metra
3. Ndriçimi publik i fshatit
4. Asfaltimi i rrugëve në disa lagje si “Fusha e Thatë” diku 1 kilometër, Lagja Millaj - dy rrugica dhe tri rrugica në Lagjen Berishaj
5. Ndërtimi i trotuarit nga shkolla deri në fshat, diku 1 kilometër.

Lloqan

1. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e zeza
2. Vendosja e orëmatësve për ujë të pijes në gjithë fshatin
3. Asfaltimi i pesë rrugicave përbrenda fshatit
4. Rrugica brenda fshatit
5. Zëvendësimi/ndërrimi i 50 shtyllave të rrymës në fshat.

Hulaj

1. Vendorsja e 24 shtyllave të reja të rrymës në fshat
2. Ndërtimi i dy kanaleve të ujitjes prej fshatit Pobërgjë deri të Hulajt diku 3 kilometra, dhe prej Lumbardhit deri në Lloqan për ta lidhur me pendën
3. Asfaltimi i disa rrugicave të fshatit - diku 500 metra gjatësi
4. Vazhdimi i kanalizimit nga Lagja Hulaj deri në Lumbardh.

Papiq

1. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujëra të zeza
2. Ndërtimi i kanaleve për ujitjen e tokave bujqësore.

Ky dokument është hartuar në kuadër të programit “Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë” i cili zbatohet nga Syri i Vizionit, Communication For Social Development, EC Ma Ndryshe dhe Democracy Plus që kanë lidhur aleancë për zbatim të këtij programi i cili mbështetet financiarisht nga Olof Palme International Center.

Komuna: Deçan, shtator 2022